

100 VJETORI | I PAVARSISË

## DOM NIKOLLE KAÇORRI

## Letrat e panjohura në arkivin e Vjenës

Pjeter Logoreci

Sejcili prej nesh e ka për detyrë me punue e me djersitë për ven din e vet, por njato qi ja kush tojnë jeten, plot me sakrifica e mundime të njimbasnjshme vendit, janë heroj e i prijnë me shembujt qi japin, ndjenjës kombëtare e atdhedash-tunisë. Nji shembull i pakrah-a-sueshëm heroizmit e ksisoj atdhedash-tunie asht personazhi shumëplanesh i Dom Nikollë Kaçorrit. Lindë e bur-rnue me pastertinë e karakterin kry-enalhtë të bjeshkve të Krejës, patrioti Kaçorri j'u kushtue i tani atdheut e fesë. Tue kenë se gjendja në kohën e fminisë tij, në atë malci për sa i per-ket besimeve dhe formimit shpirtnor ishte e shumë llojshme, Kaçorrit ju krijue rasti me vendosë kontakte sho-qnore e me kenë i mirëpritun në çdo familje të katundit, e ma vonë, gjatë jetës baritore, në gjithë krahinë.

Në karakter i drejtë, trim, i nder-shëm, i papërkulun, e i mbushun me besim te vedja, ai filloj me kenë aktiv në perpjekjet për çlirim kombëtar prej qindvjetve të errsinës aziatike të push-timit turk. Megjithëse pushtuesit e huej, e ma vonë edhe fara e keqe anti-shqiptare e komunizmit, u mundue me krijue hije e portret të padishrueshëm për patriotin Kaçorri, vepra e perpjek-jet e tij në të mirë të atdheut ishin kaq të mëdha, sa propaganda kundër tij u shue.

Tue pasë parasysh eksperiencen historike të Europës, ku çdo komb per-sonalizon e nalton demokracinë tuj vu në themel të tij herojtë e personazhet ma të spikatuna të historisë së vet, mendoj qi edhe na si shqyptarë, duhet të vendosim si gur themeli e të mar-rim për shembull, figura si patrioti Kaçorri, për të ndertue nji frymë atd-hedashunie e demokraci të shndet-shme.

Edhe pse doli në dritë libri shumë i vlefshem biografik "FEJA DHE FLA-MURI, Dom Nikollë Kaçorri", i zotni Hajredin Isufit, figura e Kaçorrit asht jo shumë e njoftun për shqyptarët. Kto ditë gjatë kërkimeve të mija nëpër arkivat e ndryshme (në ktë rast OSTA), ndesha në dy letra qi Kaçorri i drejtonte personaliteteve ma të nalta të diplomacisë austriake për të protes-tue mbi veprimet e egra qi pushtuesit turq kishin ba kundër tij dhe bash-këpunterve të tij, e mendova ti baj të njoftuna për lexuesit.

## Letra e parë

Letra e parë e shkrueme në gjuhën italiane mbanë datën: Durrazo, 20 giugno 1910 dhe i drejtohet titullarit të konsullatës austriake në Durrës, tue i pershkruue sulmin qi autoritetet turke, binbashët e gjendarmerisë, komisar i policisë Hamet Toska nën drejtimin e prokurorit Madey në Dur-rës, bane mbi famullinë e tij. Ktu po mundohem të baj disa pershtatje në gjuhën shqype të disa pasazheve të kësaj letre:

"I perndritshmi Zotni,

Sot rreth ores 9.00 alla turka u paraqiten te porta e oborrit të kësaj famullie Bimbashët e gjendarmerisë dhe Mydei (prokurori i shtetit) me perk-thyesin Mikel Rama, e më thane qi kishin ardhë zyrtarisht me ba kontroll në famulli, unë kundershtova me force tuj i diftu qi nuk do ta lejojshë ktë pa



Në foto:  
Dom  
Nikollë  
Kaçorri

lejen e Arqipeshkvit tem. Ato ngulen kambë, e unë gjithashtu kundërshtova me të njejtin arsyetim (për mung-esë urdhnit nga ana e autoritetit su-perior kishtar).

Jashtë portës, në rrugë qindroshin komisar i policisë me të gjithë trupat

e gjendarmerisë të Durrësit, të cilët kishin ardhë me ba kontrollin. Megjithatë kundërshtimet e mija, komisar i policisë Hamet Toska, mendoj qi me urdhen të superiorve, tentoj me hy me force me nji komision qi e ndiqte atë, une i dola te dera për mos me i

## Letra 1

Letra e parë e shkrueme në gjuhën italiane mbanë datën: Durrazo, 20 giugno 1910 dhe i drejtohet titullarit të konsullatës austriake në Durrës, tue i pershkruue sulmin qi autoritetet turke, binbashët e gjendarmerisë, komisar i policisë Hamet Toska nën drejtimin e prokurorit Madey në Durrës, bane mbi famullinë e tij.

## Letra 2

Letra e dytë, edhe ajo e shkrueme në gjuhën italiane i drejtohet Ministrisë së Jashtme të Austrisë e mban datën: Durazzo, 10 Aprile 1911. Imzot Kaçorri i cili në kte kohë ishte i denuem në arrest shpie, pershkruen keqtrajtimin, arrestimin e tij nga gjendarët turq dhe denimin e tij me katër vjet burg.

lejuue hymjen, por për force madhore nuk muejta me i pangue..... jas-thtë ishte mbledhë nji turmë e madhe njerzish....deshta me u largue nga pamja dhe me shku te autoritetet lokale me u ankuue për ktë dhumin, por gjandarët e policia jo vetëm me mbajtën me forcë, por më goditshin me shqelma e me kondakët e pushkve, nji nder të cilet më goditi në krye..... ndërsa kontrolli i famullisë vazhdoj për rreth 15-20 minuta."

Kjo letër të len mbresa për nga mënyra e të shkruemit e po ashtu edhe nga përmbajtja. Ajo asht e shkrueme në katër faqe dhe e firmosun prej tij.

Megjithatë ankesat e Imzot Kaçorrit pranë autoriteteve turke në vend ranë në vesh të shurdhët e nuk pat as-nji reagim për ktë. Për ktë arsye Kaçorri kërkon ti bajë me dije autoriteteve europiane, fuqive të mëdha, në ktë rast protektoratit austriak, situatën e tra-zueme politike nëpërmas diplomatëve mbrenda vendit.

Mbas përshkrimit të ngjarjes në letërën protestë të Imzot Kaçorrit drej-tue Konsullit austriak, ky i fundit i drejtohet ministrisë së jashtme të Aus-trisë me nji telegram sekret me datën 21 qershor 1910, tue i raportue mbi in-cidentin e tuj pershkruue ngjarjen në kandvështrimin e tij.

Druck

*Copia*

Durazzo, 20 Giugno 1910.

Illustrissimo Signore,

Oggi verso le 9 ore alla turca si presentarono al portone del cortile di questa casa parrocchiale il Pimbaschi di gendarmeria, ed il Mydei (procuratore di stato) coll' interprete Sig. Michal Rama, e mi dissero che erano venuti ufficialmente a fare la perquisizione di questa casa parrocchiale; io rifiutai recisamente di non poter ciò permettere senza che il mio Arcivescovo mi dia ordini in proposito. - E per quanto essi insistessero, sempre rifiutai colla stessa ragione (cioè della mancanza d'ordine da parte della mia superiore Autorità Ecclesiastica).

Sal. Cortone, in istrada, attendevano.

A. 75

durazzo, 10 Aprile 1911

Eccello Imperiale e Reale Ministero degli Affari Esteri in Vienna

Son già per compiere 10 mesi che io mi trovo prigioniero. Perci sommamente mi permette di sottoporre all'alta considerazione di questo Eccello S. e R. Dicastero come a Governu Protettore del Cattolico in Albania quanto segue:

Dove essere ben noto all' Eccello S. e R. Ministero degli Affari Esteri che io, dopo d'essere approdato a Durazzo sommerso battuto a colpi di fucile dalla gendarmeria il giorno 20 Giugno anno scorso, il 25 dello stesso Giugno fui per tradimento catturato dal Governu locale e che illegalmente e ingiustamente il giorno 11 Agosto fui condannato a quattro anni di reclusione.

Certamente sarà più noto a questo Eccello S. e R. Ministero che io tosti in appello colla Corte di Cassazione di Costantinopoli contro l' allegato ed ingiusta condanna di questo tribunale, e che la medesima Corte di Cassazione annullò del tutto la sentenza del tribunale di Durazzo.

Konsulli Halla përshkruen kundërshimin e famullarit Kaçorri që të bahet kontrolli në famulli e tregon se si ai (Imzot Kaçorri) u mbajt me forcë dhe u godit me armë nga gjendarët. Simbas konsullit: kontrolli zgjati 15 minuta, ishte thjeshtë një formalitet dhe bani një përshlyetje të keqe. Si Famullitari e po ashtu edhe Arqipeshkvi duhet të paraqiten pranë hetuesve sa herë të thirren, përndryshe do të merren me forcë. Ai kërkoi mendim nga zyra qëndrore në Vjenë për mënyrën e reagimit e tij ndaj autoriteteve turke në të ardhmen.

Lidhur me këtë ngjarje të shemturme, që ishte e paramenduar prej autoriteteve turke, pat një reagim të ashpër edhe në shtypin vendas. Shumë gazeta shqyptare njoftuan për incidentin dhe bane komentet e tyre për situatën e ndezun të atyne ditëve që bashkë me revoltat e malsorve të Kurbinut shkaktuan carjen e pushtetit otoman dhe sollen pamvarsinë e dishrue me aq fort prej shqyptarve. Ma poshtë po sjell një artikull të botuar në gazetën Korca, e cila i rreferohet një njoftimit të gazetës "Zgimi i Shqipërisë" të Janinës me 15 korrik 1910, që të përkthyer në gjermanisht, konsullata austriake në Durrës, për ta informuar për situatën e krijueme në Durrës, ja dergonte ministrisë së jashtme në Vjenë:

Artikulli përshkruen dhunen që ju ba institucionit fetar e po ashtu edhe famullarit, Imzot Kaçorrit, i cili u godit me shqelma e kondakët e pushkëve në koke e trup nga gjendarët turq. Ma poshtë autori tregon për kontrollin e famullisë i cili nuk solli asgjë komprometuese që autoritetet turke mendojshin se do të gjejnë.

Letra dytë

Letra e dytë, edhe ajo e shkrueme në gjuhën italiane i drejtohet Ministrisë së Jashtme të Austrisë e mban datën: Durazzo, 10 Aprile 1911.

Imzot Kaçorri i cili në kthe kohë ishte i denuem në arrest shpie, përshkruen keqtrajtimin, arrestimin e tij nga gjendarët turq dhe denimin e tij me katër vjet burg. Ai tregon për apelin në gjykatën e kasacionit në Konstantinopol e cila anuloi vendimin e gjykatës së Durrësit dhe e kthej atë për rigjykim. Kjo gjykatë pa zhvilluar një proces të rregullt gjyqor e denoi Imzot Kaçorrin me dy vjet burg dhe një gjobë prej 25 lirash turke. Letra asht e shkrueme në tri faqe dhe përfundon me kërkesën për anulimin e denimit me ndërhyrjen e Austrisë te Porta e Naltë. Mbas shumë përpjekjesh diplomatike të Vjenës zyrtare, u arrit që Kaçorri të lirohet me amnesti.

Interesant e për tu tregue asht edhe fakti që Imzot Kaçorri, i cili shquhej për aftësi administruese, devotshmeni e perkushtim, trimi dhe kambëngulje, u propozue nga Ipeshkvi Lazer Mjeda për postin vakant (mbas largimit në pension të Mgr. Gurinit) të Arqipeshkërit të Shkodrës. Bashkë me kandidaturën e Kaçorrit figurojshin edhe emna të njoftun si Mgr. Mjedes, Mgr. Serreqit, Mgr. Bumcit, Don Mark Shllakut. Ma vonë me emninim e Mgr. Serreqit në Shkodër, Imzot Lazer Mjeda shpreh keqardhjen e tij që kandidatura e Imzot Kaçorrit nuk pat miratimin e të huejve me arsyetimin si "gjaknxehtë e i ngutshëm në karakter" (Das k.und k. Kulturprotektorat, faqe 434).

Personalisht, qysh se fillova me kerkue e me bashkue dokumentacionin arkivor, pothuejse një shekullor për riatdhesimin e eshtnave të tij nga Vjena, rasti e pruni që të lidhem shpirtnësi me figuren e ktij atdhetarit të pashoq, shembulli i të cilit me udhëheqë në jetën e përditshme.

Telegramm

5-20-1910

10.7.

Chiffre:

Gestern wurde der Postbote des Erzbischofs Bischof in Sobjak abgeholt und bei ihm drei Kassen mit Begleitender Post mit Beschlagnahme der Post und dem ihm begleitender Beamten in der Wohnung des Pfarrers Kaçorri übergeben worden. Die Pfarrer Kaçorri wurde die Pfarrer von Gendarmen bewacht, eine Durchsuchung derselben aber nicht vorgenommen. Monsignore Kaçorri erklärte dem den abgehenden Botenbeamten, dass die Waffen und Munition nicht von ihm her und ihre Verwahrung bei ihm unbekannt. Unter den beschlagnahmten Briefen befinden sich auch einige Kaçorri's und nicht andere Briefe, die er an zwei Pfarrer der Erzdiözese richtete und in denen er den Aufstand in Serbien ankündete und die wahrscheinliche Haltung der Katholiken...

Beslage zum Protokoll des Staats

Juni 19 Juli 1911 Nr. 54

Uebersetzung eines Artikels der Zeitung "Zgimi i Shqipërisë" vom 15. Juli 1910.

Wir entnehmen das in Serbien in mehreren Zeitungen "Zgimi" folgende:

"Man schreibt aus Durazzo, dass bei der Beschlagnahme von einigen Tagen der Briefe des Katholiken Papst-Nikolaus Kaçorri's fortgenommen wurde. Man fand beim Gendarmen Briefe, welche in den Pfarrern von Durazzo, Don Mark Shllaku, adressiert waren. Der Brief wurde in der Gegenwart der Regierung die Beschlagnahme des Herrn Don Kaçorri's sowie der Katholiken Briefe an. Der Stadtgericht wurde eingeschickt und man sollte den erwähnten Briefen...

Në foto: **Katër faksimile të letrave të zbuluara në arkivin e Vjenës, letra që Kaçorri ua drejtohte personaliteteve te larta austriake ku protestonte për veprimet e egra që ushtroheshin ndaj tij e bashkëpunëtorëve të tij**

Ditëve në vazhdim do perpiqem me sjellë për lexuesit, argumenta e dokumenta të tjerë të panjoftun për Imzot Kaçorrin. Shpresoj se 100 vjetori i pamvarsisë, do të jetë një rast i mirë për shtetin e historianët, për të ba rishikimin e ktij momenti historik dhe ngritjen e shumë figurave të lanuna me qellim në harrësë, në vendin që i takon në altarin e atdheut. Figura e Imzot Nikollë Kaçorrit si e pandashme nga Ismail Qemali, i takon të jetë prezent kudo pranë tij, në cdo monument a statujë, në cdo stendë muzeumi apo poster propagandë, në cdo kumtesë e jubileum....dhe në kujtesen shqyptarve.

Shënim:

**Shkrimi i referohet dokumentave origjinal të cilët ndodhen në ÖSTA, fondi PA. Wien, 26.05.2012**